

# BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË  
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",  
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1  
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445  
Mobile: (0)68 20 67 630  
E-mail: [info@qkzh.org](mailto:info@qkzh.org)

[www.qkzh.org](http://www.qkzh.org)

Rezultatet e vrojtimt të  
biznesit dhe konsumatorëve  
Nr. 23 mars 2007




*Business and Consumer  
Survey Results  
No 23, March 2007*

## INDUSTRIA PËRPUNUESE

## MANUFACTURING SECTOR

**Treguesi i QKZH-së për besueshmërinë** në sektorin e industrisë përpunuese në muajin janar 2007 është në nivelin e 4 pikëve, nivel i cili është 6 pikë më i lartë se një vit më parë. Sigurisht, si pasojë e ndikimit sezonal, treguesi i QKZH -së i besueshmërisë është 7 pikë më i ulët se 3-muaj më parë. Vlerësimi pozitiv i treguesit të

FIGURA 1 Treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë përpunuese  
CRD Confidence indicator in manufacturing sector



QKZH-së për besueshmërinë ka ardhur nga për-mirësimi i nivelit të kontraktimeve, si dhe parashikimit në rritje për situatën e biznesit në 3 muajt e ardhshëm. Ndërsa, niveli i rritur i gjendjes së produkteve të gatshme ka ndikuar negativisht në nivelin e treguesit të besueshmërisë.

Ndryshe nga parashikimi se mungesa e energjisë elektrike mund të dobësonte apo mund të sillte ulje të aktivitetit të prodhimit në industrinë përpunuese, rezultatet e anketës për muajin janar 2007 tregojnë se në 3-mujorin e katërt të vitit 2006 shënohet përsëri një rritje e aktivitetit prodhues në këtë sektor.

Po kështu, në janar 2007 drejtuesit e firmave prodhuese paraqiten me një nivel më të lartë optimizmi se sa një vit më parë. Treguesit e monitoruar në muajin janar 2007 tregojnë gjithashtu një tendencë të qartë për rritjen e çmimeve të produkteve industriale, gjë që mund të ketë pasojë të drejtpërdrejta në rritjen e çmimeve me pakicë të

këtyre produkteve, me pasojë, sigurisht, në rritjen e presionit të inflacionit mbi ekonominë shqiptare.

Energjia elektrike del përsëri si pengesa kryesore e biznesit në sektorin e industrisë përpunuese. Por, shqetësuese për ecurinë e këtij sektori duket se po bëhet mungesa e fuqisë punëtore dhe sidomos asaj të kualifikuar. Kjo situatë mund të dëmtojë rritjen e mëtejshme të aktivitetit të biznesit në sektorin e industrisë përpunuese, në rast se nuk merren masa imediate për të plotësuar këtë nevojë të sektorit të industrisë përpunuese.

**Klima e biznesit sipas nëndegëve të industrisë përpunuese**

Sipas anketimit të muajit janar 2007, treguesi i QKZH-së për besueshmërinë në industrinë e tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve mbetet në vlera positive prej 12 pikësh, megjithëse ka një rënie prej 17 pikë në përqindje nga tre mujori i kaluar. Në industrinë ushqimore, pijeve dhe duhanit treguesi i besueshmërisë në këtë periudhë, ka kaluar në vlerën negative prej 1 pike, dhe krahasuar me tremujorin e fundit, ka një rënie prej 4 pikësh në përqindje. Për industrinë e fabrikimit të artikujve prej druri, mobililjeve, etj ka një perkeqësim të ndjeshëm të këtij treguesi në -9 pikë, nga 17 pikë që tregonte tremujorin e kaluar (shiko figurën 2). Sidoqoftë, për të dy sektorët e fundit, treguesi i besueshmërisë, krahasuar me një vit më parë ka përmirësime. Industria e letrës, kartonit, botimeve, kimike, kauçikut dhe plastikës, rafinimi i naftës dhe koksifikimi, si dhe fabrikimi i artikujve minerale jo metalike kanë rritje të treguesit të besueshmërisë për këtë tremujor dhe kanë përkatësisht vlerat prej 0 dhe 11 pikësh. Për industrinë e metalurgjisë, punimit të metaleve, fabrikimit të makinave, pajisjeve dhe pjesëve të ndërrimit, i pajisjeve elektrike etj, ka perkeqësim të këtij treguesi. Treguesi i besueshmërisë ka vlerën prej -10 pikësh, duke pasur një rënie prej 15 pikë në përqindje nga tremujori i kaluar.

**Parashikimi i prodhimit për 3 muajt e ardhshëm**

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e prodhimit në 3 muajt e ardhshëm, në muajin janar 2007 është rritur me 11 pikë në krahasim me 3 muaj më parë, duke arritur nivelin e 29 pikëve. Ky nivel është 26 pikë më i lartë se një vit më parë, gjë që tregon për një tendencë të qartë rritjeje të sektorit të industrisë përpunuese edhe në 3 mujorin e parë për vitin 2007.

**Niveli i kontraktiveve** në muajin janar 2007 vazhdon të përmirësohet për të tretin 3-mujor të njëpasnjëshëm, duke arritur nivelin e -16 pikëve, nivel i cili është 4 pikë më i lartë se 3 muaj më parë dhe 7 pikë më i përmirësuar se një vit më parë. Ky përmirësim në nivelin e kontraktiveve në sektorin e industrisë përpunuese jep një garanci për një qëndrueshmëri të aktivitetit prodhues për këtë sektor edhe në 3 mujorin e parë të vitit 2007.

FIGURA 2: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese  
CRD Confidence indicator in manufacturing branches




FIGURA 3: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese  
CRD Confidence indicator in manufacturing branches




FIGURA 4: Parashikimi i aktivitetit të biznesit në industrinë përpunuese  
Expectation of business activity in manufacturing sector





FIGURA 5: Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar  
Assesment of order-books in manufacture last 3 months



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

## Produktet e gatshme

Treguesi i nivelit të gjendjes së produkteve të gatshme (stokut) në muajin janar 2007 ka pësuar një rritje të ndjeshme prej rreth 37 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, duke arritur nivelin pozitiv prej 2 pikësh, nivel i cili është nga më të lartit i regjistruar pas vitit 2003. Në rritjen e këtij treguesi mund të ketë ndikuar një ngadalësim i rritjes së shitjeve në 3 muajin e katërt të vitit 2006, gjë e cila ka çuar në një rritje të gjendjes së produkteve të gatshme, me ndikim negativ në treguesin e besueshmërisë, dhe ndoshta edhe në gjendjen financiare të ndërmarrjeve të industrisë përpunuese.

## Vlerësimi i prodhimit në 3 muajt e mëparshëm


Balanca e përgjigjeve në lidhje me vlerësimin e aktivitetit të prodhimit në 3 muajt e mëparshëm, në muajin janar 2007 shënon rritjen e tretë radhazi duke arritur nivelin më të lartë të 3 vjetëve të fundit me 25 pikë. Ky nivel është 13 pikë më i lartë se një vit më parë, si dhe 3 pikë më shumë se 3 muaj më parë. Ky tregues konfirmon të dhënat e shënuara në treguesin e besueshmërisë në këtë sektor, i cili ka treguar këtë përmirësim për çdo 3 tremujorë të njëpasnjëshëm (shiko figurën 1). Nga figura 5 shikohet gjithashtu se tremujori i katërt i vitit 2006 duhet të jetë 3 muajori me rritjen më të lartë të prodhimit në industrinë përpunuese gjatë vitit 2006.

## Kapacitetet prodhuese

Kapacitet prodhuese në sektorin e industrisë përpunuese në muajin janar 2007 shfrytëzohen në masën 68%. Ky nivel është 3% më i lartë se 3 muaj më parë, dhe po në këtë masë edhe në krahasim me një vit më parë. Nga figura 7 shikohet se variacioni i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese për dy vjetët e fundit është në nivelet 65-70%, gjë që tregon për një stabilitet në volumin e prodhimit, por që përbën një sinjal jo shumë nxitës për rritjen e investimeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve prodhuese në sektorin e industrisë përpunuese, pasi mesatarisht mbeten pa u shfrytëzuar rreth 35% të kapaciteteve ekzistuese prodhuese. Në vendet e tjera me një sektor të industrisë prodhuese dinamike, niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese është në nivele 75-90%. Megjithatë, nga figura 7 shikohet qartë se në dy vjetët e fundit kapacitetet prodhuese në këtë sektor kanë një rritje 10-15 për qind në krahasim me periudhën 2002-2004.


Industria e tekstileve, veshjes dhe lekurë këpuceve vazhdon të ketë vlerën aktuale më të lartë të shfrytëzimit me 82 %, e ndjekur nga industria e fabrikimit të artikujve mineralë jo metalike me vlerë shfrytëzimi të kapaciteteve në masën 71 %.

FIGURA 6: Vlerësimi i produkteve të gatshme në industrinë përpunuese  
Assesment of stocks in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 7: Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar  
Assesment of production activity in manufacturing the last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 8: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese  
Capacity utilisation in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 9: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese sipas degëve të industrisë përpunuese, 2002-2006  
Capacity utilisation in manufacturing branches 2002-2006




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstileve dhe lekurë këpuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi i metaleve, pajisjeve elektr.


**FIGURA 10: Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese**  
**Assessment of production capacity in manufacturing**




**FIGURA 11: Parashikimi i çmimeve të shitjes në industrinë përpunuese**  
**Assessment of selling prices in manufacturing sector**



**FIGURA 12: Parashikimi i punësimit në industrinë përpunuese**  
**Employment expectations in manufacturing sector**



**FIGURA 13: Parashikimi i kontratave për eksport në industrinë përpunuese**  
**Export expectation in manufacturing sector**



### Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese

Gjatë anketimit të muajit janar 2007, rezultojnë që, balanca e përgjigjeve në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve të tyre prodhuese, është pozitive me 15 pikë, vlerë kjo 17 pikë në përqindje më e lartë se një vit më parë.

### Çmimet e prodhimit

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e çmimeve të produkteve industriale në muajin janar 2007 ka një tendencë të fortë rritjeje prej 19 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, si dhe 22 pikë më i lartë se një vit më parë duke arritur një nivel rekord prej 25 pikësh. Siç shpjegojmë edhe më lart tendeca për një rritje të çmimeve të produkteve industriale mund të shpjegohet lehtësisht me faktorë të brendshëm të sektorit prodhues (jo me faktorë të jashtëm makroekonomikë). Padyshim presioni kryesor që vjen nga brenda sektorit lidhet me rritjen e kostos së inputeve të industrisë përpunuese, ku padyshim më të rëndësishëm duhet të jenë nevojat për burime alternative energjitike si dhe presioni për rritjen e pagës mesatare të punonjësve të kualifikuar.

### Punësimi në 3 muajt e ardhshëm

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e punësimit në 3 muajt e ardhshëm, në muajin janar 2007 është pozitive prej 25 pikësh, por ky nivel është 14 pikë më i lartë se 3 muaj më parë, si dhe 15 pikë më i lartë se në janar të vitit 2006. Ky rezultat i treguesit të parashikimit të punësimit në këtë sektor flet për një prirje të qartë se punësimi në këtë sektor do të kërkojë që të rritet, por në kushtet e një mungese eventuale të fuqisë punëtore të kualifikuar, mund të kemi një presion për rritjen e pagës mesatare për një punëtor të specializuar në këtë sektor, me pasoja në rritjen e kostos së produkteve industriale. Kjo situatë padyshim që do të çojë në një presion më të madh të bizneseve për transferimin e kësaj kostoje në çmimet e prodhimit dhe për pasojë, kjo situatë do të bëhet një presion real edhe për rritjen e çmimeve me pakicë.

### Parashikimi i kontratave për eksport

Figura 13 paraqet vlerësimet për përgjigjet në lidhje me parashikimin e kontraktiveve për eksport. Parashikimet e nivelit të kontraktiveve për eksport paraqiten me luhajtje të theksuara nga një tremujor në tjetrin, gjë që flet se ecuria e eksporteve për këtë sektor është akoma e paqëndrueshme, megjithëse shikohen disa tendenca në stabilizim të nivelit të kontraktiveve në dy tremujorët e fundit. Si përfundim mund të thuhet se megjithëse parashikimet e nivelit të kontraktiveve janë pozitive, përsëri nuk mund të thuhet se kontraktimet e eksporteve janë në nivele të tilla që garantojnë një qëndrueshmëri dhe rritje në sektorin e industrisë përpunuese.

**Niveli i kontraktiveve në 3 muajt e kaluar**

Treguesi i vlerësimit të nivelit të kontraktiveve për 3 muajt e kaluar, në muajin tetor tregon përsëri që diferenca e përgjigjeve në përqindje për nivelin e mjaftueshmërisë është 23 pikë, me vetëm 2 pikë më pak se një 3 muaj më parë, por rreth 21 pikë më shumë se një vit më parë. Kjo tendencë pozitive në nivelin e kontraktiveve konfirmon faktin se niveli i kontraktiveve në këtë sektor po bëhet solide gjë që jep garanci të mjaftueshme për një rritje të mëtejshme të sektorit të prodhimit. Kjo do të thotë që klima ekonomike në këtë sektorë po ecën në nivele pozitive përsa i përket stabilizimit te saj.

**Garancia në muaj e nivelit të prodhimit**

Treguesi i garancisë së nivelit të prodhimit në sektorin e industrisë përpunuese tregon vlerën prej 9.5 muaj. Ky nivel është 0.5 muaj më poshtë se ai i treguar 3 muaj më parë, si dhe 1 muaj më i ulët se një vit më parë, gjë tregon për një luhatje relativisht jo shqetësuese përsa i përket nivelit të prodhimimit sepse ky tregues përgjithësisht ruan nivelin mesatar, që nga prilli i vitit 2005. Siç shikohet nga figura 15 niveli i garancisë në muaj i nivelit të prodhimit në dy vitet e fundit është përmirësuar me rreth 1.5 muaj e krahasuar kjo me vitet 2003-2005.


**Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm**

Balanca e përgjigjeve në lidhje me këtë tregues është pozitive me 5 pikë. Në sektorin e industrisë përpunuese, pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm, na shfaqet me një tendencë uljeje, po të krahasohet me një tremujor të mëparshëm. Megjithatë, kjo tendencë në rënie qëndron në vlera më të larta se një vit më parë, vlerë kjo 14 pikë në përqindje më e lartë se e njëjta periudhë e 2006. Siç shihet edhe nga grafiku, kjo tendencë në rënie është karakteristike e dalluesme për të njëjtën periudhë e të gjithë viteve në të cilët është kryer anketimi.

**Pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm**


Pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm na paraqitet në dy prizme krahasues: në tregun brenda BE, dhe jashtë atij. Duke e parë në këtë këndvështrim, 2007 na paraqitet me tendenca pozitive drejt rritjes po të krahasohet me një tremujor më parë. Kjo rritje shihet si në tregun brenda BE, ashtu edhe jashtë tij, edhe pse po të krahasojmë vlerat në të dy keta tregje do të shohim se marrëdhënia me tregun jashtë BE është më optimiste. Krahasuar me një vit më parë pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm, jashtë BE është 63 pikë në përqindje më i lartë. Gjithashtu edhe pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm, brenda BE është 22 pikë në përqindje më i lartë.

**FIGURA 14: Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar**  
Assesment of order-books in manufacture last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 15: Vlerësimi i nivelit të prodhimit në muaj në industrinë përpunuese**  
Assesment of months of production in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 16: Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm në sektorin e industrisë përpunuese**  
Competitiv position on domestic market



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 17: Pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm në sektorin e industrisë përpunuese**  
Competitiv position on foreign market



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

## Pengesat në sektorin e industrisë përpunuese Constraints within manufacturing sector


Shqetësimet që kanë menaxherët e firmave në sektorin e industrisë përpunuese në drejtim të **legjislacionit fiskal** duket se po zbuten. Kjo pasi ky kufizim në muajin janar 07 është përmendur vetëm nga 19% e të anketuarve, 37% e të anketuarve 3 muaj më parë dhe në janar të 06 43% e të intervistuarve. Niveli i regjistruar në janar të këtij viti është gjithashtu më i ulët i regjistruar për të gjithë periudhën e kryerjes së anketimit (janar 02).

Konkurenca e pandershme nga **tregu informal** po bëhet përsëri një faktor konstant për biznesin prodhues. Ky faktor përmendet nga 40% e të anketuarëve, nivel i cili është

pothuajse i njëjtë për të gjitha anketimet e zhvilluara gjatë vitit 06, gjë që tregon se qeveria gjatë këtij viti pothuajse nuk ka ndërmarrë asnjë masë për pengimit e aktivitetit informal në sektorin e industrisë përpunuese.


**Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i brendshëm** duket se po bëhet një shqetësim konstant për 28% e të anketuarve. Megjithatë ky nivel është 5% më i ulët se mesatarja e regjistruar për periudhën '02-'06, si dhe 8% më i ulët se një vit më parë, që tregon se mugesia e kërkesës nga tregu i brendshëm nuk do të ndikojë në nivelin e sotëm të prodhimit industrial.

**FIGURA 18: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal në industrinë përpunuese**  
*The impact of fiscal legislation in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 20: Ndikimi i tregut informal në industrinë përpunuese**  
*The impact of informal sector in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 22: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brënda vendit**  
*Insufficient domestic demand in manufacturing sector*



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


**FIGURA 19: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of fiscal legislation in manufacturing branches*



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve

15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve


**FIGURA 21: Ndikimi i tregut informal sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of informal sector in manufacturing branches*



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve

21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

**FIGURA 23: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brënda vendit sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*Insufficient domestic demand in manufacturing branches*




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lekurë kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve


21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

**Problemet e infrastrukturës** në përgjithësi dhe asaj rrugore në veçanti, duket se po dalin përsëri në pah si shqetësim për biznesin në këtë sektor. Këtë faktor në muajin janar e kanë cilësuar 43% e të anketuarve, duke dalë treguesi i dytë më i kuotuar nga menaxherët e firmave si faktor pengues. Ky nivel është 29% më i lartë se 3 muaj më parë e 17% më i lartë se një vit më parë, që të kujton nevojën e vazhdimit të investimeve në infrastrukturën fizike. Ndikimin e **kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm** në muajin janar 2007 duket se është zbehur akoma edhe më tej, pasi këtë faktor shqetësues e përmendin vetëm 8% e të anketuarve, nga 17% që ishte ky nivel 3

**FIGURA 24: Ndikimi i mungesës së infrastrukturës në sektorin e industrisë përpunuese**  
*The impact of lack of infrastructure in manufacturing sector*




**FIGURA 26: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm**  
*Insufficient foreign demand in manufacturing sector*



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

**FIGURA 28: Ndikimi i korrupsionit në sektorin e industrisë përpunuese**  
*The impact of corruption in manufacturing sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

muaj më parë. Lehtësimi i këtij faktori pengues ka ardhur nga një përmirësim i situatës në tregun e jashtëm, sidomos në vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, të cilët janë edhe partnerët kryesorë të biznesit në Shqipëri.


**Korrupsioni** (kryesisht nga organet tatimore) si faktor pengues duket se po e ul ndikimin e tij pengues. Kjo tendencë po vihet re qartazi edhe me rezultatet e anketimit të muajit janar 2007, ku këtë faktor e kanë cilësuar vetëm 9% e të anketuarve, i cili është jo vetëm niveli më i ulët i regjistruar, por ky shqetësim mund të konsiderohet pa ndikim në ecurinë e aktivitetit prodhues në sektorin e industrisë përpunuese.

**FIGURA 25: Ndikimi i mungesës së infrastrukturës sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of lack of infrastructure in manufacturing branches*




5-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve

**FIGURA 27: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of insufficient foreign demand in manufacturing*



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

**FIGURA 29: Ndikimi i korrupsionit sipas degëve të industrisë përpunuese**  
*The impact of corruption in manufacturing branches*



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit  
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve  
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve  
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes  
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike  
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar duket se po bëhet jo vetëm një shqetësim konstant për biznesin në sektorin e industrisë përpunuese, por ndikimi i tij negativ po vjen duke u rritur. Këtë faktor në muajin janar 2007 e kanë përmendur 40% e të anketuarve, nivel i cili është më i larti i regjistruar për periudhën 2002-2006. Në muajin tetor 2006 këtë faktor e kanë përmendur 27% e të anketuarve, ndërsa në janar të vitit 2006 ky faktor përmendet nga 33% e të anketuarve. Siç u përmend edhe më sipër mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar jo vetëm që mund të frenojë rritmet e rritjes së prodhimit industrial, por do të ndikojë në mënyrë direkte edhe në rritjen e kostos së produkteve

industriale, si rezultat i rritjes së pagës mesatare. Furnizimi me **energji elektrike** për firmat prodhuese në muajin janar 2007 është rikthyer përsëri në shqetësimin kryesor. Këtë shqetësim e kanë shprehur 80% e të anketuarve, nga 20% që ishte ky nivel 3 muaj më parë (shiko figurën 10). Ky nivel është 28% më i lartë se një vit më parë, por qëndron pothuajse në të njëjtat nivele se në janar të vitit 2004, i cili duket se ka qenë edhe periudha më e vështirë për biznesin. Mesatarisht shqetësimi i energjisë elektrike për të gjithë periudhën 2002-2006 qëndron në nivelet prej 60%. Nën këtë mesatare kanë qenë 4 periudha të njëpasnjëshme në vitin 2006.

FIGURA 30: Ndikimi i mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar në industrinë përpunuese  
*The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing sector*




FIGURA 31: Ndikimi mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar sipas degëve të industrisë përpunuese  
*The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing*




FIGURA 32: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrik e në industrinë përpunuese  
*The impact of shortages on electricity in manufacturing sector*




FIGURA 33: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike sipas degëve të industrisë përpunuese  
*The impact of shortage on electricity in manufacturing branches*




FIGURA 34: Vështirësitë financiare në sektorin e industrisë përpunuese  
*Financial constrains in manufacturing sector*





FIGURA 35: Vështirësitë financiare në industrinë e prodhimit sipas degëve të industrisë përpunuese  
*Financial constrains in manufacturing branches*



## SEKTORI I NDERTIMIT

## CONSTRUCTION SECTOR

**Klima e biznesit**

Në muajin janar 2007 besueshmëria e ndërtuesve shënon një rritje të dukshme, duke konsoliduar në këtë mënyrë rezultatet e muajit tetor 2006. Ky përmirësim i besueshmërisë dhe për rrjedhojë e klimës së biznesit në ndërtim është rezultat i rritjes së parashikimit për punësimin në 3 muajin e parë të vitit 2007, e cila tejkalon efektin negativ nga ulja e treguesit të nivelit të kontraktiveve. Po kështu, konstatohet një tendencë rritjeje e aktivitetit të ndërtimit në 3-mujorin e katërt të vitit 2006. Çmimet në ndërtim edhe për 3 muajin e parë të këtij viti do të kenë një tendencë në rritje, por me një ritëm më të ulët se gjatë vitit 2006.

Në muajin janar 2007 treguesi i besueshmërisë së QKZH-së për sektorin e ndërtimit shënon një rritje prej 4 pikë në krahasim me 3 muaj më parë, si dhe 8 pikë në përqindje në krahasim me një vit më parë. Përmirësim i treguesit të biznesit jep gjithashtu për një rritje të volumit të ndërtimit në 3 muajin e parë të vitit 2007 në krahasim me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar.

**Punësimi**

Indikatori i parashikimit të punësimit për 3 muajt e ardhshëm ka pësuar një rënie të fortë prej 21 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, si dhe 24 pikë në krahasim me një vit më parë, duke arritur nivelin e 23 pikëve në përqindje. Ky nivel është pothuajse në nivelin më të lartë të konstatuar, gjë që tregon për një tendencë të qartë të rritjes së nivelit të punësimit në këtë sektor të paktën për 3 muajin e parë të vitit 2007.

**Kontraktimet**

Treguesi i mjaftueshmërisë në nivelin e kontraktiveve në muajin janar 2007 ka shënuar një rënie prej 14 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, si dhe 8 pikë kundrejt një viti më parë, duke arritur nivelin e -31 pikëve. Ky nivel i mjaftueshmërisë së kontraktiveve është niveli më i ulët historik për të gjithë periudhën e investimeve prill 2002. Dobësimi në nivelin e kontraktiveve, në rast se konstatohet edhe në 3 muajin e ardhshëm do të çojë në mënyrë të padiskutueshme në një frenim të aktivitetit të ndërtimit, si dhe në një përkeqësim të situatës financiare të firmave të ndërtimit.

**Vlerësimi i aktivitetit ndërtues në 3 muajt e fundit**

Treguesi i vlerësimit të aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit ka një rritje me 3 pikë në krahasim me 3 muaj më parë. Nga figura 4 shikohet se nivelet e këtij treguesi në 2 vjetimet e vitit 2006 janë më të ulëta se ato të vërtetuara në vitin 2005, çka tregon për një ulje të ritmeve të rritjes së sektorit të ndërtimit në vitin 2006 në krahasim me dy 3 muajin e fundit të vitit 2005.

FIGURA 36: Treguesi i besueshmërisë së QKZH-së në sektorin e ndërtimit  
CRD confidence indicator in construction sector




FIGURA 37: Parashikimi i punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit  
Employment Expectation in construction sector (next 3 months)




FIGURA 38: Vlerësimi i nivelit të kontratave në sektorin e ndërtimit  
Assessment of order-books





FIGURA 39: Vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit  
Assessment of business activity in the last 3 months / construction sector



### Çmimet e ndërtimit

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e çmimeve të prodhimit në sektorin e ndërtimit në muajin janar 2007 është pozitiv prej 25 pikë në përqindje. Ky nivel tregon se të paktën 25% më shumë biznesmenë deklarojnë se do të rrisin çmimet kundrejt atyre që mendojnë të kundërtën ose do t'i mbajnë çmimet e qëndrueshme. Megjithatë ky nivel është 18 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë dhe 14 pikë më i ulët se një vit më parë, gjë që tregon se rritja e çmimeve në ndërtim nuk do të vazhdojë me ritme më të ulëta rritjeje. Kjo tendencë në rënie e rritmeve të rritjes së çmimeve në ndërtim do të thellohet akoma më shumë në 3-mujorët e ardhshëm në rast se nuk do të përmirësohet niveli kontraktive në ndërtim.

### Kontratat në muaj pune

Kontratat e shprehura në muaj pune në muajin janar 2007 arrijnë në nivelin e 8 muajve, nivel ky që është 2 muaj më i ulët se 3 muaj më parë dhe 1 muaj më i ulët se një vit më parë. Përkeqësimi i muajve në kontraktive është rezultat i përkeqësimit të nivelit të kontraktave të reja, e cila u paraqit edhe në treguesin e mjaftueshmërisë së kontraktave.

## Pengesat në sektorin e ndërtimit Constraints within construction sector


### Lejet e ndërtimit

Lejet e ndërtimit vazhdojnë të jenë një shqetësim për ndërtuesit, pasi 44% e tyre shprehen se ky faktor është pengesë për aktivitetin e tyre ndërtues. Megjithatë, ky nivel shqetësimi është 9 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë dhe 14 pikë më i ulët se një vit më parë. Megjithatë ky faktor kufizues është një ndër dy faktorët me te ndjeshëm nga ndërtuesit, ai është në nivelet me te ulta që nga viti 2004

### Kërkesa konsumatore


Në muajin janar 2007, 21% e të anketuarve shprehen se kanë mungesë të kërkesës konsumatore. Ky nivel është 6 përqind më i ulët se 3 muaj më parë, por gjithashtu ai është 15 pikë në përqindje më i lartë se një vit më parë. Nga figura 7 shikohet se ky nivel i shqetësimit të ndërtuesve është në nivelin e mesatares së konstatuar për të gjithë periudhën 5-vjeçare të anketimit (prill 2002-janar 2007). Siç theksuam edhe më lart ndikimi i mungesës së kërkesës konsumatore mund të çojë në një rritje të presionit mbi ndërtuesit për të zbutur tendencën për rritjen e çmimeve në ndërtim.

Figura 40: Parashikimi i çmimeve të ndërtimit  
Price expectations in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 41: Vlerësimi i nivelit të kontraktive në muaj në sektorin e ndërtimit  
Work already contracted in months in construction sector - total




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 42: Ndikimi i procedurave për leje ndërtimi  
Building licensing procedures




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 43: Ndikimi i mungesës së kërkesës në sektorin e ndërtimit  
Insufficient demand




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 44: Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit  
*The impact of financial legislation*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 45: Konkurrencë e pandershme nga tregu i zi në sektorin e ndërtimit  
*Unfair competition by black market in construction sector*




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 46: Ndikimi i mungesave të energjisë elektrike  
*The impact of shortages on electricity*



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 47: Korrupsioni në organet tatimore  
*Corruption on tax department*



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

### Legjislacioni fiskal

Në muajin janar 2007 17% e të anketuarve shprehen të pakënaqur me legjislacionin fiskal në fuqi, kundrejt 23% që ishin 3 muaj më parë dhe 54% një vit më parë. Nga figura 10 shikohet, gjithashtu, që ky nivel perceptimi i ndikimit negativ të legjislacionit fiskal në ndërtim, është niveli më i ulët nga të gjitha anketimet e zhvilluara që nga prilli i vitit 2003 kur ky nivel ka qenë në vlerat e 39%, pra 12 pikë në përqindje më i ulët. Kjo tendencë në rënie vjen si pasojë e përmirësimit të mjedisit ekonomik në sektorin e ndërtimit.

### Tregu informal

Në muajin janar 2007, 18% e të anketuarve deklarojnë se janë të shqetësuar nga konkurrenca e pandershme e tregut të zi, fakt ky që i dëmton në segmente të ndryshme të biznesit të tyre. Ky nivel është 5 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë dhe 8 pikë më i ulët se një vit më parë, gjë që tregon për ulje të ndjeshme të ndikimit negativ të informalitetit në sektorin e ndërtimit. Sipas një rezymeje të shkurtër të historikut të anketimit të kryer nga QKZh-ja mund të shohim se piku i ndikimit negativ të tregut informal shihet të ketë qenë në 3-mujorin e dytë të 2005-ës kur arriti vlerën e 57 pikëve në përqindje.

### Energjia elektrike

Përkeqësimi i furnizimit me energji elektrike në muajt nëntor – dhjetor 2006 ka ndikuar në rritjen e shqetësimit të ndërtuesve për këtë faktor. Nga një faktor me një ndikim pothuajse të papërfillshëm që ishte energjia elektrike në muajin tetor 2006, ku vetëm 4% e ndërtuesve deklarorin këtë shqetësim, ai rritet me 55% në janar të 2007. Ky nivel shqetësimi është pothuajse në nivelin mesatar të ndikimit të këtij faktori në sektorin e ndërtimit për të gjithë periudhën 5 vjeçare të anketimit. Por gjithsesi shpreh një hap aspak pozitiv që është bërë për të përmirësuar gjendjen e furnizimit me energji elektrike në përgjithësi dhe furnizimit me energji të këtij sektori më në vecanti.

### Korrupsioni i organeve tatimore

Korrupsionin në organet tatimore e përcaktojnë si pengues në aktivitetin e tyre ndërtues një numër gjithnjë e më i vogël ndërtuesish, ose vetëm 6% e të anketuarve. Ky nivel është, gjithashtu, më i ulëti i regjistruar, duke zbritur në mënyrë të ndjeshme, sidomos po të krahasohet me nivelin e një viti më parë, kur ky tregues shënonte nivelin 20%. Po kështu, nga figura shikohet gjithashtu, se ky nivel është rreth 24 pikë në përqindje se mesatarja e përgjigjeve të konstatuar gjatë periudhës 5 vjeçare të anketimit 2002-2006, gjë që flet për një përmirësim të punës së tatimorëve.

## **TË PËRGJITHSHME**

Gjatë anketimit të muajit janar 2007 u kontaktuan rreth 520 firma në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit në rrethet Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Shkodër. nga të cilat u përgjigjën brenda periudhës së anketimit, rreth 490 firma. Anketimi i biznesit në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit ka filluar në muajt janar dhe prill të vitit 2002. Anketimi bazohet mbi vlerësimin cilësor të opinionëve të menaxherëve apo pronarëve të ndërmarrjeve të kontaktuar. Vlerësimet cilësore përpunohen në formën e treguesit të Balancës, e cila shpreh diferencën midis përgjigjeve optimiste (në rritje, apo përmirësim) kundrejt atyre pesimiste (në ulje, apo përkeqësim) duke përjashtuar nga vlerësimi opinionet që shprehin situatë të pandryshuar. Në këtë mënyrë kur balanca e përgjigjeve është pozitive vlerësimet e optimistëve tejkalojnë ato të pesimistëve dhe në të kundërtën do të kishim një balancë negative. Klima e biznesit vlerësohet nëpërmjet indikatorit të besueshmërisë. Ky indikator për sektorin e industrisë përpunuese llogaritet si mesatare aritmetike e tre indikatorëve: parashikimit të prodhimit, vlerësimin e kontratave të realizuara, dhe vlerësimin e produktit të gatshëm (i marrë me shenjë të kundërt). Për sektorin e ndërtimit indikatorit i besueshmërisë llogaritet si mesatare aritmetike e treguesit mbi vlerësimin e kontraktimeve aktuale dhe parashikimit të punësimit.

### **QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM**

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është kryerja e studimeve dhe analizave ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit nëpërmjet anketimeve periodike. Duke analizuar problematikat e biznesit dhe publikut dhe shpërndarjen e rezultateve synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të jetës të të gjithë qytetarëve.

Drejtoresha Ekzekutive/ *Executive Director*:  
Mirlinda Rusi (Gajo)

Anëtarët e grupit / *Group's members*  
Komola Sako  
Rozi Beqiri  
Bexhet Hyka

Duke ndjekur të njëjtën praktikë për periudha rigorozisht të përcaktuara (mujore apo tremujore), mbi bazën e balancave ndërtohen indikatorë të caktuar të biznesit që shprehin situatën e biznesit në raport me periudhat e mëparshme, situatën aktuale dhe parashikimin për një periudhë të paktën 3 mujore. Anketimet e biznesit shërbejnë, gjithashtu, jo vetëm për të ndjekur tendencën e biznesit, por me anë të tyre diktohen ciklet e biznesit, si dhe pikat e kthesës në ciklin e biznesit.

Kjo metodë anketimi zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet Kandidate, si dhe me pak ndryshime në të gjitha vendet anëtare të OECD-së. Në Evropë, një nga institutet më prestigjioze që ka filluar anketimet cilësore të biznesit është KOF Instituti Zvicerian për Analizën e Ciklit të Biznesit në Zyrih, Zvicër (viti 1955). Stafi teknik i QKZH-së në periudhën 8 -12 qershor 2005 ka marrë pjesë në tavolinat e punës të organizuara nga KOF posacërisht për rritjen e kapaciteteve teknike të saj në fushat specifike si: hartim metodologjie për përzgjedhjen e kampionit në sektorët e industrisë përpunuese dhe ndërtimit për Shqipërinë; analizë ekonomike për interpretim të rezultateve në lidhje me tendencën e biznesit dhe vlerësimin e indikatorëve sintetike; implementim teknik të tendencave sipas anketimit në bizneset industri përpunuese dhe ndërtim.

### *CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT*

*CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publishes research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.*